



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.21 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 03 mars 2025 miraton:

RREGULLORE NR.02/2025
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.02/2023 PËR
VEPRIMTARINË, ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht, në kapitullin III, sa i përket Zyrës së Drejtorit të Sekretariatit.

Neni 2

Në kapitullin III të nenit 9, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8 shtohen nënparagrafët 1.8.3 dhe 1.8.4 dhe paragrafët 2, 3 dhe 4, me tekstin në vijim:

Neni 9
Zyra e Drejtorit

1. Zyra e Drejtorit të Sekretariatit përbëhet nga:

- 1.8. Stafi profesional dhe administrativ si në vijim:
- 1.8.3. Menaxher i Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- 1.8.4. Zyrtar i Lartë Ligjor.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit për periudhën e realizimit të mandatit të tij mund në çdo kohë të transferojë cilindo zyrtar brenda sistemit prokurorial apo jashtë institucionit të sistemit prokurorial në Zyrën e tij, me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Zyrtarët e transferuar nga institucionet jashtë sistemit prokurorial mund të transferohen në kategori të njëjtë apo në kategori të ndryshme sipas klasifikimit të pozitave të sistemit prokurorial dhe me marrëveshje mes dy institucioneve, të nënshkruar nga zyrtarët kryesorë administrativë të institucioneve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 03 mars 2025

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës